

**Gjykata Themelore e Mitrovicës**  
**PM nr. 01/2016**  
**18 prill 2016**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**Gjykata Themelore e Mitrovicës** – trupi gjykues për të mitur - i përbërë nga Nuno Manuel Ferreira de Madureira si kryetar i trupit gjykues të EULEX-it për të mitur, Kimete Fejza gjyqtare laike dhe Novak Mirkoviq gjyqtar laik, në cilësinë e anëtareve të trupit gjykues, me ndihmën e zyrtares ligjor Vera Manuello, si procesmbajtëse, në lëndën për të mitur kundër:

**A. P.**, emri i babës, B\_\_\_\_, i nënës, S\_\_\_\_, i vajzërisë S\_\_\_\_, i lindur me \_\_\_\_ në \_\_\_\_ - shqiptar i Kosovës, me banim në \_\_\_\_ – rruga \_\_\_\_ nr \_\_, nr i letërnjoftimit, nuk dihet, i pamartuar, profesioni: i papunë, ka të kryer shkollën fillore, ka qenë në paraburgim nga 25 qershori 2015 deri me 10 gusht 2015;

**A. S.**, emri i babës, X\_\_\_\_, i nënës, A\_\_\_\_, i vajzërisë B\_\_\_\_, i lindur me \_\_\_\_ në \_\_\_\_ të \_\_\_\_, shqiptar i Kosovës, me banim në \_\_\_\_ – rruga \_\_\_\_ nr \_\_ – kati \_\_, nr i letërnjoftimit, nuk dihet, i pamartuar, me profesion: nxënës i shkollës së mesme (viti i parë);

**V. B.**, emri i babës, E\_\_\_\_, i nënës, V\_\_\_\_, i vajzërisë F\_\_\_\_, i lindur me \_\_\_\_ në \_\_\_\_, shqiptar i Kosovës, me banim në \_\_\_\_ – rruga \_\_\_\_ nr \_\_, nr i letërnjoftimit, nuk dihet, i pamartuar, me profesion: nxënës i shkollës së mesme (viti i parë);

**M. D.**, emri i babës, B.1.\_\_\_\_, i nënës, S.2.\_\_\_\_, i vajzërisë K\_\_\_\_, i lindur me \_\_\_\_ në \_\_\_\_ – \_\_\_\_, shqiptar i Kosovës, me banim në \_\_\_\_ në \_\_\_\_, nr i letërnjoftimit, nuk dihet.

**B. S.**, emri i babës, M\_\_\_\_, i nënës, F.1.\_\_\_\_, i vajzërisë K.1.\_\_\_\_, i lindur me \_\_\_\_ në \_\_\_\_, shqiptar i Kosovës, me banim në \_\_\_\_ – \_\_\_\_, nr i letërnjoftimit, nuk dihet; dhe

**E. R.**, emri i babës, S.3.\_\_\_\_, i nënës, A\_\_\_\_, i vajzërisë N\_\_\_\_, i lindur me \_\_\_\_ në \_\_\_\_, shqiptar i Kosovës, me banim në \_\_\_\_ – rruga \_\_\_\_ nr \_\_, nr i letërnjoftimit, nuk dihet;

të cilët akuzohen me:

**Pika I**

A.P. \_\_\_\_\_, A.S. \_\_\_\_\_, M.D. \_\_\_\_\_, V.B. \_\_\_\_\_ dhe E.R. \_\_\_\_\_:

- 1) Vrasje e rëndë në tentativë në kundërshtim me neni 179, nënpara (1.10) të KPRK-së në lidhje me nenin 28 dhe 31 të KPRK,

**Pika II**

V.B. \_\_\_\_\_, M.D. \_\_\_\_\_ dhe A.S. \_\_\_\_\_;

- 2) Kërcënim në kundërshtim me nenin 185, para (1) dhe (4) të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së,

Valdrin Beqiri:

- 3) Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 374, para (1) I KPRK-s;

**Pika III**

A.P. \_\_\_\_\_, A.S. \_\_\_\_\_, M.D. \_\_\_\_\_, V.B. \_\_\_\_\_ dhe B.S. \_\_\_\_\_:

- 4) Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik në kundërshtim me nenin 147, para (1) dhe (3) të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;
- 5) Kanosja në kundërshtim me nenin 185, para (1) dhe (4) të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së,
- 6) Vjedhje në kundërshtim të nenit 325 para (2) të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;

V.B. \_\_\_\_\_ dhe A.P. \_\_\_\_\_,

- 7) Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me nenin 374, para (1) I KPRK-s;

**Pika IV**

A.P. \_\_\_\_\_:

- 8) Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik në kundërshtim me nenin 147, para (1) dhe (3) të KPRK-së.

*Në pajtim me nenin 73 të para (3) të Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM),*

Lëshon këtë:

## AKTVENDIM

### I. Masat e caktuara

1. Gjykata i shqipton të miturit **A.P.** \_\_\_\_\_ masën edukative institucionale dhe shqipton dërgimin e tij në ndonjë institucion edukativo-korrektues **për 2 vite**, në pajtim me nenin 20 para (4) dhe nenin 28 të KDM-së;
2. Gjykata i shqipton të miturit **A.S.** \_\_\_\_\_ masën e mbikëqyrjes së shtuar dhe e vendos në mbikëqyrje të shtuar nën organin e kujdestarisë **për 10 muaj**, sipas nenit 20 para (3) dhe nenit 25 të KDM-së.  
Organi i kujdestarisë ka obligim:
  - Të siguroj largimin e të miturit nga ndonjë ndikim negativ, sidomos duke mos kaluar kohë me të miturit tjerë që janë pjesë e kësaj lënde dhe të mos ketë qasje në rrjetin social Facebook. I mituri duhet t'ia jap fjalëkalimin e llogarisë së Facebook-ut kujdestarit të vet.
  - Ta angazhoj të miturin në programe me komponentë ndëretnike.
3. Gjykata i cakton të miturit **V.B.** \_\_\_\_\_ masën e mbikëqyrjes së shtuar dhe e vendos në mbikëqyrje të organit të kujdestarisë **për 1 vit**, në pajtim me nenin 20 para (3) dhe nenin 25 të KDM-së,  
Organi i kujdestarisë ka obligim:
  - Të siguroj largimin e të miturit nga ndonjë ndikim negativ, sidomos duke mos kaluar kohë me të miturit tjerë që i takojnë këtij rasti dhe të mos ketë qasje në Facebook. I mituri duhet t'ia jap fjalëkalimin e llogarisë së Facebook-ut kujdestarit të vet.
  - Ta angazhoj të miturin në programe me komponentë ndëretnik.
4. Gjykata nuk i cakton masë as dënim të miturit **M.D.** \_\_\_\_\_,
5. Gjykata nuk i cakton masë as dënim të miturit **B.S.** \_\_\_\_\_,
6. Gjykata nuk i cakton masë as dënim të miturit **E.R.** \_\_\_\_\_.

### II. Konfiskimi

Konfiskohet pistoleta Ekol Volga, EVL – \_\_\_\_\_, me gëzhjën e vet, sipas nenit 374, para 3 të KPRK.

### III. Kostoja e shpenzimeve

Shpenzimet e procedurës i mbulon buxheti i Kosovës sipas nenit 75 para (1) të KDM-së.

#### **IV. Kërkesa pasurore**

Palët e dëmtuara udhëzohen të ushtrojnë kërkesë pasurore juridike në kontest civil sipas nenin 75 para (1) të KDM-së.

-----  
Nuno Madureira

Kryetar i trupi gjykues i EULEX-it për të mitur

-----  
Vera Manuello

Procesmbajtëse

Zyrtare ligjore e EULEX-it

#### **Këshillë Juridike:**

Personat e autorizuar kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë kundër këtij aktvendimi brenda 8 (ditëve) pas t'u dorëzohet palëve (neni 77 i KDM).